

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR SHKËMBIM PËRVOJASH NË PROCESET TEKNIKE**

NDËRMJET:

**MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL (MBPZHR),
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

**MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL (MBZHR),
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë më poshtë referuar si "Palët".

Të udhëhequr nga qëllimi për bashkëpunim midis Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural i cili është i domosdoshëm për zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale dhe afatgjatë dhe për besimin reciprok ndërmjet palëve kontraktuese dhe qytetarëve të tyre përkatës në veçanti të fermerëve.

Me synim dhënien e kontributit pasi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) e cila ka mandat në krijimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve në fushën e bujqësisë duke përfshirë veterinarinë dhe pylltarinë dhe në kontekst të kësaj Marrëveshjeje, Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike dhe Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore do të vendosin kornizat e bashkëpunimit teknik me Drejtorinë Përgjegjëse për Ekstensionin Bujqësor dhe Drejtorinë Përgjegjëse për Statistikat Bujqësore nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Duke pasur parasysh se, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e Republikës së Shqipërisë në takimin e përbashkët të dy qeverive, më datë 26.11.2021 në Elbasan, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit në fushën e bujqësisë.

Të bindur se kjo marrëveshje do të kontribuojë dhe do të hapë rrugë në avancimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural do të ketë interes dhe përfitime reciproke dhe në përputhje me ligjet kombëtare të dy shteteve, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë marrëveshjen si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave, njohurive në fushën e bujqësisë specifikisht në statistikat bujqësore dhe shërbimet këshillimore, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi të secilës prej palëve si dhe me të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare.

Neni 2 Bashkëpunimi

1. Palët shprehin gatishmërinë e tyre për të përmirësuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë mes dy ministrive në fushat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi , si vijon;
2. Shkëmbim përvojash dhe informacioni në:
 - 2.1. Fushën e statistikave bujqësore përfshirë, rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në fermë (FADN), të dhënat e çmimeve për produktet bujqësore dhe të dhënat lidhur me shkëmbimet tregtare;
 - 2.2. Zhvillimin e Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor, në zhvillimin dhe organizimin e komponentëve përbërës të sistemit;
 - 2.3. Hartimin e raporteve dhe analizave për të dhënë rekomandime për hartimin e politikave bujqësore;
 - 2.4. Raportimin e të dhënave vjetore të shkëmbimit tregtar në nënkomitetin për Bujqësinë dhe Peshkimin në Komision Evropian, si dhe raportimin e çmimeve për produktet bujqësore në DG-AGRI;
 - 2.5. Organizimin e përbashkët të takimeve, konferencave, seminareve si dhe shkëmbim të përvojave në trajnime dhe konsultime (që zgjasin deri në 5 ditë) me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe punonjësve të të dy departamenteve në fusha me interes të përbashkët, duke pasur parasysh disponueshmërinë e burimeve financiare të të dyja Palëve.
3. Shërbimet Këshillimore
 - 3.1. Shkëmbimi i përvojave në zbatimin e politikave bujqësore, në përafrimin e legjislacionit, organizimin dhe funksionimin në fushën e Shërbimeve Këshillimore në nivel të dy vendeve;

3.2.Shkëmbimi i përvojave në rritjen e kapaciteteve prodhuese të fermerëve përmes trajnimit, edukimit dhe vizitave të dyanshme;

3.3.Shkëmbimi i përvojave për zhvillimin e zonave rurale përmes avancimit të Shërbimeve Këshillimore,

3.4.Shkëmbimi i përvojave në ngritjen e kapaciteteve të këshilluesve publiko –privat,

3.5.Shkëmbim përvojash në fushën e transferimit të kërkimit të aplikuar dhe inovacionit në bujqësi.

Neni 3 Detyrimet e Palëve

1. Palët janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe për detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tyre kombëtare.
2. Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike dhe Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës dhe Drejtoritë Përgjegjëse për Ekstensionin Bujqësor dhe për Statistikat Bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që të sigurojnë mjetet e nevojshme financiare nga buxheti i tyre (kombëtar), ose sigurimin e mbështetjes financiare nga burime ndërkombëtare për realizimin e bashkëpunimit që rrjedh nga kjo Marrëveshje.
3. Për realizimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të angazhohen së bashku për rritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimin midis dy vendeve të cilat kanë për qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4 Konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit

1. Për çdo të dhënë statistikore e cila shkëmbet mes palëve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet ruajtur konfidencialiteti në përputhje me legjislacionin kombëtar që përcaktojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe zyrtare.
2. Palët që zotërojnë të dhënat e marra në përputhje me këtë Marrëveshjeje do të trajtojnë informacionin e marrë në mënyrë konfidenciale, pa e ndarë me persona të paautorizuar, si dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të veçantë për paanshmërinë dhe konfidencialitetin.

Neni 5 Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshjeje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.

2. Marrëveshja lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar deri kur njëra palë njofton palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfundimin e saj.

3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi mund të ndryshohet me miratimin reciprok me shkrim të Palëve në çdo kohë. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve.

Nënshkruar në PRISHTINË më 20.06.2022 në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.


Për Ministrinë e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
së Republikës së Kosovës

FATON PEÇI


/Nënshkrimi/

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural të Republikës
së Shqipërisë

FRIDA KRIFCA


/Nënshkrimi/